VENDIM
Nr.391, datë 1.6.2011

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË "NXITJA E BIZNESIT SOCIAL" SHA

(Ndryshuar me VKM nr. 701, datë 9.9.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.10 376, datë 10.2.2011 "Për krijimin e shoqërisë "Nxitja e biznesit social" sh.a.", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e statutit të shoqërisë "Nxitja e biznesit social" sh.a., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STATUTI I SHOQËRISË
"NXITJA E BIZNESIT SOCIAL" SHA

TITULLI I
EMËRTIMI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI

Neni 1
Emërtimi

1. Shoqëria emërtohet "Nxitja e biznesit social" sh.a. (këtej e tutje referuar si "Shoqëria").
2. Shoqëria është një shoqëri aksionare me ofertë private, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2
Selia

1. Selia e shoqërisë është në Tiranë, Shqipëri.
2. Këshilli i administrimit mund të hapë dhe/ose të mbyllë shoqëri të kontrolluara, degë, agjenci ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4
Objekti

1. Objekti i shoqërisë është zhvillimi ekonomik dhe social i qëndrueshëm, përmes nxitjes për zhvillim në nivel kombëtar të një biznesi social të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv.

2. Për arritjen e qëllimit të sipërpërmendur, shoqëria ndjek qëllimet e saj sociale dhe mjedisore, përmes mbështetjes dhe nxitjes së bizneseve sociale dhe të mikrofinancës, si dhe krijon mundësi për të ardhura të qëndrueshme për shtresat e varfra të shoqërisë në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund t'ua delegojë disa prej veprimtarive të saj palëve të treta, në mënyrë që t'i arrijë këto qëllime sociale dhe mjedisore.

3. Një biznes social është biznesi që ka për qëllim zgjidhjen e problemeve sociale dhe mjedisore, në të cilin fitimet nuk paguhen në formën e dividentëve dhe që respekton parimet në vijim:

a) qëllimi i biznesit nuk është maksimizimi i fitimeve, por përqendrimi në zgjidhjen e problemeve sociale ose mjedisore;

b) biznesi social karakterizohet nga qëndrueshmëria ekonomiko-financiare;

c) investitorët nuk përfitojnë divident përtej shumës së derdhur në shoqëri;

ç) fitimi i krijuar nga biznesi social riinvestohet brenda biznesit, për të zgjeruar dhe përmirësuar impaktin e tij, ose përdoret për veprimtari të tjera biznesi social;

d) biznesi social është i ndërgjegjshëm për impaktin e tij në mjedis.

TITULLI II
KAPITALI, AKSIONET DHE TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Neni 5
Kapitali

1. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është ALL 2 000 000 (dy milionë) lekë, i përbërë nga 10 000 (dhjetë mijë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale prej ALL 200 (dyqind) lekësh shqiptarë secili.

2. Në çastin e themelimit, kapitali është nënshkruar dhe është shlyer tërësisht, si më poshtë vijon:

- shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, ka kontribuar në para në kapitalin e shoqërisë, me një shumë të barabartë prej ALL 2 000 000 (dy milionë) lekësh shqiptarë.

3. Në çastin e themelimit, bazuar në kontributet e sipërpërmendura:

- shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, zotëron 10 000 (dhjetë mijë) aksione të barabarta me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë (këtej e tutje referuar si "Aksionari i vetëm").

Neni 6
Aksionet dhe regjistri i aksioneve

1. Aksionet e shoqërisë janë të zakonshme.

2. Çdo aksion jep të drejtën e një vote.

3. Një akt emetimi aksionesh hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe përmban informacionet e kërkuara nga ligji.

4. Shoqëria harton dhe mban një regjistër të aksionarëve në selinë e shoqërisë, ku përcaktohen:

- emri dhe mbiemri ose emërtimi i shoqërisë;
- numri i aksioneve;
- vlera nominale e aksioneve;
- adresa ose selia e aksionarëve;
- regjistrimi i datës së kryerjes së transaksionit.

5. Aksionarët e regjistruar në regjistrin e aksionarëve prezumohen aksionarë të shoqërisë me të drejta të plota, si në marrëdhëniet me shoqërinë, ashtu edhe ndaj të tretëve.

Neni 7
Transferimi i aksioneve

Transferimi i aksioneve te të tretët i nënshtrohet miratimit të aksionarit të vetëm dhe kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar për privatizimet.

Neni 8
Rritja e kapitalit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë pa limit, në çdo çast, një ose disa herë, kapitalin e shoqërisë në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

2. Kontributet e reja për rritjen e kapitalit të shoqërisë mund të konsistojnë në para ose pasuri dhe të drejta të vlerësueshme në para. Kontributet nuk mund të jenë në punë apo shërbime.

Neni 9
Zvogëlimi i kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e shoqërisë në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II
ORGANET E SHOQËRISË, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Neni 10
Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë janë:
a) Asambleja e Përgjithshme;
b) Këshilli i administrimit;
c) Administratori.

Neni 11
Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj
(shtuar shkronja "ç/1" në pikën 3 me VKM nr. 701, datë 9.9.2020)

1. Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

2. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme në një shoqëri me një aksionar ushtrohen nga aksionari i vetëm.

3. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të zakonshme për çështjet e mëposhtme:
a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
b) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
c) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proceset gjyqësore ndaj anëtarëve të

këshillit të administrimit dhe/ose administratorit;

ç) rregullat që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në Asamblenë e Përgjithshme;

ç/1) Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;

d) çdo çështje tjetër, të përcaktuar nga ligji apo statuti.

4. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të jashtëzakonshme për çështjet e mëposhtme:

a) ndryshimin apo plotësimin e statutit të shoqërisë;

b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;

c) riinvestimin e fitimeve vjetore;

ç) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

d) ndryshimet në të drejtat që lidhen me aksionet e kategorive të ndryshme;

dh) riorganizimin, shpërndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo likuidimin e shoqërisë, si edhe riorganizimin e shoqërisë në një formë tjetër;

e) ndërmarrjen e çdo veprimi i cili pritet në mënyrë të arsyeshme se do të çojë në likuidimin e shoqërisë.

5. Nëse mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk mbahet si rrjedhojë e mungesës së aksionarit të vetëm, asambleja mund të mblidhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, pas thirrjes së parë.

Neni 12

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, rendi i ditës dhe pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo këshilli i administrimit.

2. Asambleja e Përgjithshme thirret sa herë që të jetë e nevojshme, për interesat e shoqërisë ose, në rast se kërkohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda muajit qershor të çdo viti, me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit ushtrimor të mëparshëm.

3. Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo është e qartë një humbje prej 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit apo nëse ekziston rreziku se shoqëria gjatë veprimtarisë së saj nuk do të jetë në gjendje të mbulojë detyrimet e saj brenda 3 (tre) muajve të ardhshëm.

4. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme bëhet me letër rekomande, me njoftim marrjeje apo postë elektronike, me marrje përgjigjeje të dërguar në adresën e aksionarit të vetëm, të regjistruar në regjistrin e aksionarëve, ose në adresën elektronike të aksionarit, të paktën 21 (njëzet e një) ditë, përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.

5. Në njoftim jepen:

a) emërtimi dhe selia e shoqërisë dhe lloji i Asamblesë së Përgjithshme;

b) rendi i ditës, vendi, koha dhe data e thirrjes së parë dhe të dytë të Asamblesë së Përgjithshme;

c) një përshkrim i qartë dhe i saktë për procedurat, të cilat duhet të ndiqen nga aksionarët, në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin pjesë dhe të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme.

6. Rendi i ditës përmban vendimet e propozuara për çdo çështje, për të cilën Asambleja e Përgjithshme merr një vendim. Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të marrë vendime, që kanë të bëjnë me projektpropozimet për ndryshime në statut, i përfshin si çështje të rendit të ditës këto projektpropozime.

7. Asambleja e Përgjithshme nuk diskuton çështje, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës. Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme nuk ndryshohet në njoftimin e dytë.

8. Asambleja e Përgjithshme mbahet pa respektuar formalitetet e sipërpërmendura nëse është i pranishëm aksionari i vetëm dhe nëse aksionari i vetëm nuk e kundërshton mbajtjen e saj.

9. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mbahet në një vendndodhje, të ndryshme nga

selia e shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

10. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e personave të pranishëm në vende të ndryshme, të lidhur nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, në përputhje me metodat e zakonshme të telekomunikimit, ku përfshihen mjetet elektronike, me kusht që të gjithë aksionarët, të cilët marrin pjesë nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës apo mjeteve të ngjashme elektronike, të identifikohen dhe atyre t'u jepet mundësia për të ndjekur diskutimet, për të marrë pjesë drejtpërdrejt në çështjet e trajtuara dhe për të marrë, dërguar ose shqyrtuar dokumentet.

11. Aksionari i vetëm ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht aksionar, në bazë të një prokure me shkrim. Në çdo rast, prokura jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë të Përgjithshme dhe është e vlefshme për thirrjen e saj të parë dhe të dytë.

12. Aksionari nuk mund të lëshojë një prokurë për një pjesë të aksioneve që ai zotëron dhe të votojë personalisht për pjesën tjetër të këtyre aksioneve.

13. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të marrin pjesë edhe anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratori.

Neni 13

Drejtimi i Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga kryetari i këshillit të administrimit apo, në mungesë të tij, nga nënkryetari ose, në mungesë të tij, nga aksionari i vetëm a nga një person tjetër, i emëruar për këtë qëllim nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse nuk kërkohet prania e një noteri publik, Asambleja e Përgjithshme duhet të emërojë një sekretar, i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht aksionar.

2. Kryetari duhet të verifikojë vlefshmërinë e pjesëmarrjes së personave të pranishëm dhe rregullsinë e thirrjeve e të mbledhjes së asamblesë. Kryetari vendos për rendin e diskutimit dhe procedurat e votimit.

Neni 14

Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme regjistrohet në procesverbal. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.

2. Në procesverbal shënohen të dhënat në vijim:

- vendi dhe data e mbledhjes;
- rendi i ditës, emri i kryetarit dhe emri i personit që mban procesverbalin;
- rezultatet e votimit;
- vendimet e marra dhe qëndrimi i kryetarit në lidhje me vendimmarrjen.

3. Procesverbalit i bashkëngjiten lista e pjesëmarrësve, si dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

4. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 15

Këshilli Mbikëqyrës

(ndryshuar me VKM nr. 701, datë 9.9.2020)

Shoqëria mbikëqyret nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 16

Kohëzgjatja në detyrë e anëtarëve të këshillit të administrimit

Anëtarët e këshillit të administrimit emërohen në detyrë, për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 17

Largimi i anëtarëve të këshillit të administrimit

(shfuqizuar shkronja "b" *me VKM nr. 701, datë 9.9.2020)*

Detyra e anëtarit të këshillit të administrimit përfundon kur personi:

a) pushon së qeni anëtar i këshillit të administrimit, në bazë të neneve 157 e 167 pika 4 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";

b) shfuqizuar;

c) vuan apo mund të vuajë nga çrregullime mendore;

d) jep dorëheqjen nga detyra, duke njoftuar shoqërinë;

ç) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi, pa lejen e anëtarëve të tjerë të këshillit të administrimit, në mbledhjet e këtij këshilli, të mbajtura gjatë kësaj periudhe, dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të këshillit drejtues, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 18

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

(ndryshuar me VKM nr. 701, datë 9.9.2020)

a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

c) Të përgatisë me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme marrjen e masave që janë kompetencë e kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të vlefshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;

ç) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

d) Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

dh) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

e) Të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e të publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë vitit financiar;

ë) Të sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar;

f) Të përcaktojë shpërblimin e administratorit;

g) Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

gj) Të kryejë veprimet e tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 19

Mbledhjet e këshillit të administrimit

1. Të gjitha mbledhjet e këshillit të administrimit mbahen në selinë e shoqërisë apo në një vend tjetër, sipas kërkesës së kryetarit të këshillit drejtues apo të shumicës së anëtarëve të këtij këshilli.

2. Këshilli i administrimit mblidhet jo më pak se 3 (tri) herë në vit, me intervale jo më të gjata se 4 (katër) muaj dhe në mënyrë të jashtëzakonshme, sa herë që vlerësohet si e nevojshme nga kryetari i këshillit të administrimit ose kurdo, që kërkohet nga një e treta e këtij këshilli.

3. Njoftimi i thirrjes, i nënshkruar nga pala apo palët thirrëse, në të cilin përcaktohen ora, dita, vendi, si dhe rendi i ditës, duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të këshillit të administrimit me letër, telegram, teleks, telefaks, e-mail apo me anë të çdo mjeti tjetër elektronik, i cili garanton marrjen e tij, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, para datës së caktuar për mbledhjen. Ky afat mund të zvogëlohet në 48 (dyzet e tetë) orë, në raste urgjence. Mbledhja e këshillit të administrimit quhet e thirrur rregullisht edhe pa përmbushur këto formalitete, nëse të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit ose përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje.

4. Pala apo palët thirrëse vënë, gjithashtu, në dispozicion të çdo anëtari të këshillit të administrimit të gjithë informacionin apo dokumentacionin e nevojshëm, për çështjet që trajtohen, të paktën 7 (shtatë) ditë, para datës së caktuar për mbledhjen dhe, në rast urgjence, 48 (dyzet e tetë) orë përpara.

5. Këshilli i administrimit quhet i mbledhur rregullisht, nëse është e pranishme më shumë se një e dyta e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash. Në rast barazie votash, vota e kryetarit të këshillit të administrimit është vendimtare. Procesverbali i këshillit të administrimit nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari.

6. Çdo mbledhje e këshillit të administrimit kryesohet nga kryetari i tij apo, në rast pamundësie ose në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të këshillit të administrimit, me moshën më të vjetër ndër të tjerët. Këshilli i administrimit emëron një sekretar të mbledhjes, i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht anëtar.

7. Mbledhjet e këshillit të administrimit mund të zhvillohen, gjithashtu, nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës apo me mjete të ngjashme elektronike, me kusht që anëtarët e tjerë, të cilët marrin pjesë nëpërmjet telekonferencës apo videokonferencës ose nëpërmjet mjeteve të tjera të ngjashme, të identifikohen dhe të kenë mundësi të ndjekin diskutimet, të marrin pjesë në kohë reale në çështjet e diskutuara dhe të marrin, të transmetojnë dhe të shqyrtojnë dokumentet. Në këtë rast, mbledhja e këshillit të administrimit konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhen kryetari dhe sekretari i mbledhjes.

8. Kryetari mund të ftojë administratorin e shoqërisë për të marrë pjesë, për të paraqitur dhe/ose për të diskutuar për çështje, të lidhura me rendin e ditës së mbledhjes së këshillit të administrimit.

Neni 20

Administratori

(ndryshuar me VKM nr. 701, datë 9.9.2020)

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë, për një periudhë trevjeçare, si dhe merr vendim për revokimin e administratorit.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të caktohen si administrator. Kufizime të tjera lidhur me emërimin e administratorit parashikohen në pikën 2, të nenit 158, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Neni 21

Kompetencat e administratorit

(ndryshuar me VKM nr. 701, datë 9.9.2020)

Politikat tregtare të shoqërisë administrohen nga shoqëria dhe përfaqësohen nga administratori, i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e tij në përputhje me parashikimet e neneve 158, pikat 3 e 5, dhe 159, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqëria "Nxitja e biznesit social" sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 22
Kontabiliteti

Shoqëria mban llogari të sakta dhe përgatit pasqyrat financiare, në të cilat paraqitet, në mënyrë të hollësishme, gjendja e saj financiare, në përputhje me parimet e konsoliduara të kontabilitetit. Forma e llogarive dhe e pasqyrave financiare dhe mënyra e paraqitjes me hollësi të tyre janë në përputhje me ato standarde kontabiliteti, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23
Eksperti kontabël i autorizuar

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë ekspertë kontabël të jashtëm e të pavarur, të cilët janë ekspertë kontabël të autorizuar sipas ligjit.

2. Ekspertët kontabël të autorizuar kanë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 24
Viti financiar, pasqyrat financiare vjetore dhe ndarja e dividentëve

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

2. Fitimet, që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, shpërndahen, si më poshtë vijon:

a) 5% (pesë për qind) në vit caktohet si rezervë ligjore, deri në një maksimum prej 10% (dhjetë për qind) të kapitalit;

b) pjesa e mbetur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme riinvestohet në shoqëri ose në fonde të tjera rezervë.

3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që fitimet të riinvestohen ose të destinohen në një fond special rezervë apo të vendosë një rritje kapitali.

Neni 25
Prishja, ndarja dhe bashkimi

1. Shoqëria mund të prishet, si rrjedhojë e vërtetimit të shkaqeve, të parashikuara nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

2. Shoqëria mund të ndahet apo të bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 26
Likuidimi

1. Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.

2. Në përputhje me këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët hartojnë raportin përfundimtar për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë dhe për procedurat e kohën e duhur për likuidimin.

3. Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos për

bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit.

4. Pas shlyerjes së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të mbetura, likuiduesit u shpërndajnë aktivet e mbetura aksionarëve.

Neni 27

Dispozita përfundimtare

Çështjet, që nuk parashikohen shprehimisht nga ky statut, rregullohen nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".